



Duke u mbështetur në nenin 11, 12 paragrafi 12.2 shkronjën d), neni 14 paragrafi 1, nenin 17 shkronjën s). Neni 40. Paragrafi 40.2 shkronjën l) dhe neni 58 shkronja a), b), d), g), i) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040. Neni 10 pikën 4) dhe 11 të Statutit të Komunës së Klinës, si dhe në mbështetje të nenit 5, 6, 7, dhe 13 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim pronën e paluajtshme të komunës. Neni 6 të Rregullores (QRK)– Nr.09/2020, me kërkesën e Drejtorisë Për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi të datës 12.12.2023 nr. prot.01Nr-463-41731/2023, me kërkesën e kryetarit të komunës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e XI-të të rregullt për vitin 2023 të mbajtur me 22.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

Për miratimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës së Klinës

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi për miratimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës së Klinës dhe publikimin e tyre në Web Faqe të Komunës.
2. Pjesë përbërse e këtij vendimi është lista e përgjithshme e pronave të paluajtshme komunale.
3. Kjo listë e përgjithshme e pronave të paluajtshme të Komunës së Klinës, do të vlej deri me datë: 31.12.2024
4. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
5. Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Kadastrës, Gjeodezisë dhe Pronësisë, Arkivi i Komunës së Klinës dhe Zyra për Informim.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-43406 /23
Klinë me 28.12 /23



Kryesuesi,
Fadil Gashi